



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	20.05.2025
REFERENC-Ë:	24/6145/MMPHI
PËR/ZA/TO:	N.T.P. "Unio - Commerce" Sh.p.k. Fabrikë për prodhimin e bllokave të lehtë të autoklavizuar, Doganaj, Kaçanik
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për refuzimin e kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar, të operatorit N.T.P. "Unio - Commerce" Sh.p.k. me nr.prot. 24/6145/MMPHI, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e bllokave të lehtë të autoklavizuar.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/6145/MMPHI
Datë: 20.05.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenin 7, paragrafi 5 të Ligjit Nr.08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes , nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit N.T.P. "Unio-Commerce" Sh.p.k. i refuzohet kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e bllokave të lehtë të autoklavizuar, Doganaj, Kaçanik, në ngastrat kadastrale nr.00534-0, 00534-2, 00541-0, 00542-0, 00547-0, 00548-2, 00546-0, 00543-1, 00545, 00544-0, 00540-1, zona kadastrale Doganaj, Kaçanik, sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar të operatorit N.T.P. "Unio-Commerce" Sh.p.k. për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e bllokave të lehtë të autoklavizuar.

Kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar, operatori i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, të lëshuar nga MTI;
- Aplikacionin për Leje Mjedisore të Integruar;

MMPHI, pas realizimit të vizitës në teren, ka kërkuar nga kompania plotësimin e dokumentacionit dhe kushteve të cekura më poshtë:

- Në aplikacion te pika 2.1.1. keni shënuar (9.0 Kaldajat për prodhimin e avullit- Fabrika e Silcaporit posedon 2 lloj kaldaja për prodhimin e avullit për procesin e prodhimit në ngritjen e temperaturës gjatë përzirjes të masës dhe terjen e masës në dhomë klimatizuese si dhe në procesin e autoklavizimit. Kaldajat me kapacitet 2 x 6 ton/h, duke përdorur Mazutin dhe kaldaja me kapacitet 10 ton/h duke përdorur thëngjillin -Lignit.Kaldajat me Mazut). Në lidhje me këtë pikë, gjatë vizitës së komisionit keni deklaruar se keni zëvendësuar mazutin si lëndë djegëse dhe tani përdorni metanin (për çka ekziston rezervuari dhe kaldaja e re), ndërsa thëngjillin si lëndë djegëse e keni zëvendësuar me frutet e thata të ullinjve;
- Në aplikacion keni bashkangjitur raportin e matjeve të emisioneve në ajër (gazrave) të shkarkuara nga impianti me lëndë djegëse të ngurtë, nga oxhaku i kaldasë që përdor si lëndë djegëse thëngjillin. Po ashtu keni bashkangjitur edhe raportin e pluhurit total të depozituar nga pika e monstrimit e vendosur në platon e kompanisë;

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Komisioni kërkon që të riplotësohen pikat e aplikacionit që ndërlidhen me përdorimin e lëndëve djegëse te kaldajat, në përputhje me gjendjen faktike në terren: Pikat 2.1.1.; 2.3.1.; 13.3.; Tabela 5; tabela 8; tabela 15; tabela 16; tabela 17; tabela 18;

- Lejen Ujore për shkarkim;
- Kontratë me kompaninë e cila posedon Leje Mjedisore për grumbullimin e mbeturinave metalike;
- Raportin e matjeve të emisioneve në ajër (gazrave) të shkarkuara nga impianti me lëndë djegëse të ngurtë, nga oxhaku i kaldasë që përdor si lëndë djegëse frutet e thata të ullinjve (ndërlidhet me riplotësimin e pikave të aplikacionit);
- Kontratë me kompaninë prej nga furnizoheni me rërën e kuarcit;
- Pëlqim nga AME për rezervuarin e metanit;
- Kontratë me kompaninë prej nga furnizoheni me metan;
- Kontratë me kompaninë prej nga furnizoheni me frutet e thata të ullinjve;

Andaj në përputhje me Ligjin Nr.08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, MMPHI merre **Vendim që operatorit të lartcekur t'i refuzohet kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Inegruar.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.


 Izedin Bytyqi
 U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi t'i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës-Kaçanik;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së